


**A K T – T H E M E L I M I
I SHOQERISE “NIKO KOMPANI” SH.P.K.**



Sot, ne Tirane, me daten 10.02.2004, me cilesine e ortakut te vetem themelues te shoqerise:

NIKOLIN JAKA, i biri i Frrokut, vtl. 1972, lindur ne Rreshen dhe banues ne Tirane ne adresen: rruga e Elbasanit, pall. Fratari, me zotesi te plete per te vepruar,

Ka vendosur themelimin e shoqerise tregtare “NIKO KOMPANI” SH.P.K. Me nenshkrimin e ketij akti themelimi te nje shoqerie tregtare, nenshkruesi dhe themeluesi i saj merr persiper te realizoje e te respektajoje te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga klausolat e meposhtme, te cilat do te specifikohen gjeresisht ne Statutin e shoqerise:

Neni 1

Ne perputhje me kerkesat e ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare” krijohet nga shtetasi shqiptar Nikolin JAKA i cili eshte ortak i vetem i shoqerise shoqeria tregtare e emertuar “NIKO KOMPANI” SH.P.K.

SELIA E SHOQERISE

Neni 2

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane ne adresen: rruga “Luigj Gurakuqi”, pallati i ri 12-katesh, kati I. Shoqeria ka te drejte te operoje me zyra, filiale, dege apo agjenci ne te gjithe territorin e Shqiperise apo edhe jashtë shtetit.

KOHEZGJATJA

Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte e pakufizuar dhe fillon ne momentin e rregjistrimit te shoqerise ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Neni 4

Shoqeria “Niko Kompani” Sh.p.k, ka shenjat e saj dalluese si vulen dhe logon te cilat e identifikojne ate.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe perbehet nga 100 kuota me viere nominative 1.000 secila.

Pronesa mbi kapitalin themeltar te shoqerise eshte 100 % e ortakut te vetem themelues Nikolin JAKA.

Shoqeria gjate aktivitetit te saj mund te rrise apo te zvogeloje kapitalin e saj themeltar ne perputhje me procedurat e percaktuara ne Statutin e shoqerise dhe ne ligjin tregtar shqiptar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin tregtar aktual shqiptar do te jete:

- Ushtimi i veprimtarise ne fushen e ndertimeve dhe shfrytezimit te tyre, qe perfshin:
 - Ndertimin dhe shfrytezimin e pallateve dhe banesave te cdo lloji;
 - Ndertimin dhe shfrytezimin e te gjitha llojeve te objekteve social – kulturore si psh: shkolla, kopshte, parqe, terrene sportive, ujesjelles, kanalizime, rruge, autostrada etj;
 - Ndertimin dhe shfrytezimin e hoteleve, moteleve, campingjeve, fshatrave turistike, bareve, restoranteve etj;
 - Ndertimin dhe shfrytezimin e te gjitha llojeve te ambienteve te argetimit si kinema, teater, disk, pub, etj;
 - Ndertimin dhe shfrytezimin e te gjitha llojeve te sallave te lojrave si salla bilardo, bowling, ping pong, lojra elektronike, qitje argetuese, luna park etj
- Prodhimi, importimi, eksportimi dhe tregtimi me shumice e pakice i materialeve te lendeve te para per ndertim si me poshte:
 - Te gjitha llojet e inerteve qe prodhohen prej guri, zhavorri apo rere;
 - Parafabrikate prej betoni dhe hekuri e betoni te te gjitha llojeve dhe dimensioneve;
 - Tulla, tjegulla etj;
 - Si dhe cdo material apo lende e pare tjeter qe perdoret ne ndertime te te gjitha llojeve.
- Financimi ne fushen e ndertimit dhe te turizmit;
- Pjesemarria ne shoqeri te tjera nepermjet krijimit te tyre apo bierje te kuotave te kapitalit themeltar me vendim Ortakut te vetem;
- Perveç veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine sipermanrese te shoqerise do te hyje çdo veprimtari tjeter industriale tregtare, financiare dhe qe do te konsiderohet nga ortaku i vetem, e nevojshme dhe e pershatshme per realizimin e objektit te shoqerise.

DREJTIMI I SHOQERISE

Neni 7

Drejtimi i shoqerise "Niko Kompani" SH.P.K. kryhet nga administratori i saj njekohesish ortaku themelues i shoqerise z. Nikolin JAKA. Ai perfaqeson shoqerine ne te gjitha marredheniet e saj me te tretet.

Neni 8

Administratori ka te drejte te emeroje administratore te tjere te shoqerise apo te caktoje me prokure perfaqesues te tij per realizimin e te drejtave dhe detyrimeve te administratorit te shoqerise.

Ai gjithashtu ka te drejte te caktoje financiere, likuidatore per problemet e shoqerise, si dhe te punesoje persona te tjere ne shoqeri. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare 3-mujore, 6-mujore dhe vjetore te aktivitetit te shoqerise.

Neni 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut te vetem te saj i cili vendos edhe per destinacionin e tyre.

Neni 10

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Neni 11

Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarrveshjeve midis ortakeve dhe interpretimin e akteve te shoqerise eshte Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

Neni 12

Ky Akt Themelimi hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga aksioneri.


Neni 13

Ky Akt Themelimi hartohet ne Tirane ne 3 ekzemplare originale, duke patur secila te njejtene vlera ligjore e kuptimore.

Ortaku i vetem pasi u njoh dhe kuptoi drejt te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga ky Akt Themelues i Shoqerise "NIKO KOMPANI" Sh.p.k, e gjeti ne perputhje me vullnetin e tij dhe e firmosi rregullisht ate.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE "NIKO KOMPANT" SH.P.K.
NIKOLIN JAKA

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 409 Rep.**



VERTETIM

Sot, me 4-09 2004 (dymije e kater), ne Tirane, para meje noteres Elsa SINA, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne rruga "Mihal Grameno" u paraqit ortaku i vetem themelues i shoqerise "Niko Kompani" Sh.p.k.:

Nikolin JAKA, i biri i Frrokut, dtl. 1972, lindur ne Rreshen dhe banues ne Tirane ne adresen: rruga e Elbasanit, pall. Fratari, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, i njohur personalisht prej meje noteres, i cili me deklaroji se jashte kesaj zyre dhe me vullnetin e tij te lire ka marre e formuluar kete AKT-THEMELIMI te shoqerise "Niko Kompani" Sh.p.k te cilin ia lexoj dhe ai e nenshkruan ate rregullisht para meje.

Une, noteri, konform ligjit e vertetoj ate.




HYRJE

Ne mbeshtetje te ligieve nr . 7632 , 7638 e 7667 qe rregullojne marredheniet tregtare dhe funksionimin e shoqerive

NIKOLIN JAKA, i biri i Frrokut, lindur me 1972, lindur ne Rreshen dhe banues ne Tirane ne adresen: rruga e Elbasanit, pall. Fratari, shtetas shqiptar, me zotesi te plete per te vepruar,
me cilesine e ortakut te vetem themelues ne date 10.02.2004, hartoi kete statut te Shoqerise tregtare "NIKO KOMPANI" SH.P.K.

STATUTI I SHOQERISE "NIKO KOMPANI" SH.P.K.

KAPITULLI I - DISPOZITA TE PERGJITHSHME



Neni 1

Emertimi

1.1 Krijohet shoqeria "**NIKO KOMPANI**" SH.P.K. Ky emertim eshte i vetmi i shoqerise dhe perdoret ne te gjithe rregjistrimet, transaksionet, marreveshjet dhe komunikimet e saj me te tretet apo shtetin dhe eshte i vlefshem si jashte dhe brenda vendit.

1.2 Shoqeria "Niko Kompani" sh.p.k. eshte shoqeri me perjegjesi te kufizuar.

1.3 Shoqeria ka vulen dhe logon e saj identifikuese, ne formen dhe me ekstremitet e caktuara nga ortaku i vetem.

Neni 2

Themeluesi

Shoqeria themelohet nga shtetasi shqiptar **Nikolin JAKA** i cili eshte ortak i vetem i shoqerise.

Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise

3.1. Objekti i veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin tregtar aktual shqiptar do te jete:

- Ushtimi i veprimtarise ne fushen e ndertimeve dhe shfrytezimit te tyre, qe perfshin:
 - Ndertimin dhe shfrytezimin e pallateve dhe banesave te cdo lloji;
 - Ndertimin dhe shfrytezimin e te gjitha llojeve te objekteve social – kulturore si psh: shkolla, kopshte, parqe, terrene sportive, ujesjelles, kanalizime, rruge, autostrada etj;
 - Ndertimin dhe shfrytezimin e hoteleve, moteleve, campingjeve, fshatrave turistike, bareve, restoranteve etj;
 - Ndertimin dhe shfrytezimin e te gjitha llojeve te ambienteve te argetimit si kinema, teater, diskos, pub, etj;

Statuti i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "NIKO KOMPANI" Sh.p.k.



- Ndertimin dhe shfrytezimin e te gjitha llojeve te sallave te lojrave si salla bilardo, bowling, ping pong, lojra elektronike, qitje argetuese, luna park etj
- Prodhimimi, importimi, eksportimi dhe tregtimi me shumice e pakice i materialeve te lendeve te para per ndertim si me poshte:
 - Te gjitha llojet e inerteve qe prodhohen prej guri, zhavorri apo rere;
 - Parafabrikate prej betoni dhe hekuri e betoni te te gjitha llojeve dhe dimensioneve;
 - Tulla, tjegulla etj;
 - Si dhe cdo material apo lende e pare tjeter qe perdoret ne ndertime te te gjitha llojeve.
- Financimi ne fushen e ndertimit dhe te turizmit;
- Pjesemarrija ne shoperi te tjera nepermjet krijimit te tyre apo blerje te kuotave te kapitalit themeltar me vendim Ortakut te vetem;
- Perveç veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine supermarrese te shoqerise do te hyje çdo veprmtari tjeter industriale tregtare, financiare dhe qe do te konsiderohet nga ortaku i vetem, e nevojshme dhe e pershtatshme per realizimin e objektit te shoqerise.

3.2 Pershkrimi i objektit te shoqerise ka natyre indikuese dhe jo kufizuese. Per realizimin e qellimit te saj shoqeria mund te bashkepunoje me çdo person fizik apo juridik ne çdo menyre qe e gjykon te dobishme.

3.3 Shoqeria ne çdo kohe mund te ripercaktoje objektin e saj, ta shtoje apo pakesoje ate, me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 4

Selia e shoqerise dhe deget

4.1 Selia e shoqerise do te jete ne Tirane ne adresen: rruga "Luigj Gurakuqi", pallati i ri 12-katesh, kat I.

4.2 Shoqeria ke te dreje te operoje me zyra, filiale, dege apo agjenci ne te gjithe territorin e Shqiperise apo edhe jashtë shtetit.

4.3 Zyrat, filialat, deget apo agjencite krijohen me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise, i cili organizon punen dhe emeron organet drejtuese dhe perfaqesuesit e tyre ligjor.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise

5.1 Kohezgjatja e shoqerise "Niko Kompani" sh.p.k eshte e pakufizuar dhe fillon ne momentin e rregjistrimit te shoqerise ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykatës se Shkallës se Pare Tirane.

5.2 Ky afat mund te ndryshohet ne çdo kohe me vendim te ortakut te vetem me te njejten procedure qe percakton ligji tregtar per ndryshimin e statutit.

KAPITULLI II - KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke dhe perbehet nga 100 kuota me vlerë nominative 1.000 secula.

Statuti i shoqerise me perjegjesi te kufizuar "NIKO KOMPANI" Sh.p.k.

6.2. Pronesi mbi kapitalin themeltar te shoqerise eshte 100 % e ortakut te vetem Nikolin JAKA.

Neni 7

Depozitimi i kapitalit

Kapitali themeltar shlyhet plotesisht nga ortaku i vetem perpara rregjistrimit te shoqerise ne Rregjistrin Tregtar.

Neni 8

Ndryshimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise mund te shtohet apo te pakesohet vetem me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 9

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerjen e bilanceve periodike i perkasin ortakut te vetem, por kurdohere pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

Neni 10

Shoqeria "Niko Kompani" sh.p.k eshte perdonuese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje e te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ose jomateriale duke perfshire edhe te drejten e shitjes se pasurise se vet te te tretet.

Neni 11

Shoqeria "Niko Kompani" sh.p.k vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejtat e detyrimet vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaku themelues i shoqerise mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise vetem deri ne nivelin e kapitalit se investuar ne te.

KAPITULLI III - DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 12

Shoqeria "Niko Kompani" sh.p.k do te drejtohet nga Administratori i saj, njekohesishjt Ortak i Vetem themelues i shoqerise, Z. Nikolin JAKA.

Neni 13

Jane ne kompetencen ekskluzive te ortakut te vetem te shoqerise te drejtat dhe marrja e vendimeve per:

- Ndryshimin e Aktit te Themelimit dhe Statutit te shoqerise;
- Miratimin e buxhetit vjetor te shoqerise, te raporteve te administrimit, te inventareve dhe bilancit e llogarive vjetore te saj;
- Zgjedhjen e administratoreve jo-ortake dhe caktimin e detyrate e kompetencave te tyre, pervec atyre te percaktuara ne Statut;
- Aprovimin e garancive qe jep shoqeria;
- Miratimin e cmimeve dhe tarifave te mallrave apo sherbimeve qe ofron shoqeria ne treg;
- Fillimin dhe ndërprerjen e marredhenieve te punes me punemarresit e shoqerise;

Statuti i shoqerise me perjegjesi te kufizuar "NIKO KOMPANI" Sh.p.k.

- Caktimin dhe ndryshimin e shenjave dalluese te shoqerise si vula dhe logoja e saj;
- Mbikqyrjen e administratorit te shoqerise ne menyren se si ai kryen detyren e tij;
- Zhveshjen nga kompetencat te administratorit jo-ortak dhe kryerjen nga ana e tij te te gjitha veprimeve te administrimit te shoqerise ne emer dhe per llogari te saj;
- Cdo kompetence tjeter qe i jepet nga ligji tregtar.

Neni 14

Administratori jo-ortak pervec detyrave qe i caktojne ortaket e shoqerise ka edhe keto te drejta e detyra te tjera:

- Te mireadministroje pasurine e shoqerise;
- Te lidhe marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kompetencave te caktuara nga ortaku i vetem;
- Te zbatuje rregulloren e brendshme te shoqerise;
- Te shperbleje demet qe i vijne shoqerise si pasoje e veprimeve apo mosveprimeve te tij;
- Te paguhet per punen e kryer ne baze te marreveshejs se bere midis tij dhe ortakut te vetem;
- Te marre te dhena e te beje propozime mbi gjithshka qe ai e quan te dobishme per shoqerine;
- Te kryeje cdo detyre tjeter qe i ngarkohet nga ortaku i vetem i shoqerise.

Neni 15

Ushtrimi i vitit finanziar

Ushtrimi finanziar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.

Perjashtimisht ushtrimi i pare finanziar perfshin kohen nga data e regjistrimit ne Reginistrin Tregtar gjer me 31 dhjetor.

Neni 16

Inventari dhe llogarite vjetore

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.

Ne mbyllje te ushtrimit, administratori harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin finanziar.

Neni 17

Raportet Vjetore

17.1 Ne mbylljen e çdo viti finanziar Administratori ben inventaret dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton nje raport me shkrim per ortakun e vetem.

17.2 Bilancit i bashkengjiten nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria dhe nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria

17.3 Raporti pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit finanziar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e rendesishme, etj.

Statuti i shoqerise me perjegjesi te kufizuar "NIKO KOMPANI" Sh.p.k.

Neni 18

Rezultatet e ushtrimit dhe caktimi i fitimeve

18.1 Rezultati i ushtrimit percaktohet si diferenca ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire te keto te fundit amortizimet dhe provisionet.

18.2 Shuma e fitimeve te mbetura pas heqjeve per krijimin e rezervave perfaqeson dividentin, i cili i shperndahet.

18.3 Duke perjashtuar rastin kur eshte vendosur zvogelimi i kapitalit, nga fitimet e ushtrimit nuk behet asnje heqje dhe asnje derdhje dividenti, ne qofte se kapitalet e veta jane ose do te beheshin me te vogla se shuma e kapitalit themeltar plus shumen minimale te kerkuar per rezerven e domosdoshme.

18.4 Ne qofte se ekziston nje humbje, kjo mbartet per t'u perfshire ne fitimet e ushtrimit te ardhshme deri ne shuarjen e saj.

Neni 19

Reserva e domosdoshme dhe e nevojshme

19.1 Nga fitimi i rezervuar gjate vitit finanziar pasi zbriten humbjet e vitit te meparshem, hiqet menjane nje shume e barabarte me 1/20 e fitimit e destinuar per formimin e fondit rezerve te quajtur "rezerve e domosdoshme".

19.2 Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 1/10 e kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur per nje arsye çfaredo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 1/10 e kapitalit.

Neni 20

Fitimi qe shperndahet

Koha, menyra dhe shuma e fitimit qe shperndahen vendoset rast pas rasti nga Ortaku i vetem sipas raportit te administrimit ne perputhje me kete Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare te shoqerise.

KAPITULLI V - DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 21

Likujdimi I shoqerise

21.1 Menjehere pas marjes se vendimit per prishjen e shoqerise, ortaku i vetem cakton nje likuidator, kompetencat e tij dhe menyren e likuidimit te shoqerise, ne perputhje me dispozitat perkatese te ligjit tregtar.

21.2 Likuidatori i emeruar nga ortaku menjehere apo merr detyren eshte i detyruar te publikoje bilancin e shoqerise duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vene ne dispozicion menjehere ortakut te vetem.

21.3 Me caktimin e likuidatorit pezullohen te gjitha kompetencat e Administratorit dhe ato i kalojne likuidatorit.

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 22

Dispozita te fundit

22.1 Per te gjitha çeshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozitat e ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Pershqerite tregtare".

Statuti i shoqerise me perjegjesi te kufizuar "NIKO KOMPANI" Sh.p.k.

22.2 Per efekt te interpretimit te ketij Statuti me ligj tregtar nenkuftohet ligji nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

22.3 Pavlefshmerite eventuale te dispozitave te veçanta te Statutit nuk mund te cenojne vlefshmerine e tij.

Neni 23

Personaliteti juridik i shoqerise

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Neni 24

Gjykata kompetente

Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarrveshjeve midis ortakeve dhe interpretimin e statutit te shoqerise eshte Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

Neni 25

Hyrja ne fuqi

Ky Statut hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga ortaku i vetem.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES
I SHOQERISE "NIKO KOMPANI" SH.P.K.**

NIKOLIN JAKA



REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr 426 Rep.

V E R T E T I M

Sot, me 4.02. 2004 (dymije e kater), ne Tirane, para meje noteres Elsa SINA, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me seli ne rruga "Mihal Grameno" u paraqit ortaku i vetem themelues i shoqerise "Niko Kompani" Sh.p.k.:

Nikolin JAKA, i biri i Frrokut, diti 1972, lindur ne Reshen dhe banues ne Tirane ne adresen: rruga e Elbasanit, pall. Fratari, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plete per te vepruar, i njojur personalisht prej meje noteres,

i cili me deklaroi se jashte kesaj zyre dhe me vullnetin e tij te lire ka marre e formuluar kete STATUT te shoqerise "Niko Kompani" Sh.p.k te cilin ia lexoj dhe ai e nenshkruan ate rregullisht para meje.

Une, noteri, konform ligjit e vertetoj atë.

